

## **Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**

PASQYRAT FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME  
RREGULLAT DHE RREGULLORET E BANKËS QENDRORE TË  
KOSOVËS

SI DHE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2017  
ME RAPORTIN E AUDITORËVE TË PAVARUR

**PËRMBAJTJA**

	<b>Faqe</b>
<b>RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR</b>	
<b>PASQYRAT FINANCIARE:</b>	
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>1</b>
<b>PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËPËRFSHIRËSE</b>	<b>2</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË</b>	<b>4</b>
<b>SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE</b>	<b>5-37</b>



Ernst & Young Certified Auditors Ltd -  
Kosovo  
Rr Pashko Vasa 16/7  
Prishtine, Kosova

Tel +381 38 220 155  
Fax +381 38 220 155  
ey.com

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Türkiye İş Bankası A.Ş. - DEGA NË KOSOVË

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Türkiye İş Bankası A.Ş. - DEGA NË KOSOVË (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur të Bankës më 31 dhjetor 2017 janë përgatitur, në të gjithë aspektet materiale, në përputhje me Rregullat dhe Rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK").

### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Theksim çështje - Baza kontabël dhe kufizimi i përdorimit

Ne tërheqim vëmendjen për Shënimin 2 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan bazën kontabël. Pasqyrat financiare janë përgatitur për të ndihmuar Bankën që të jetë në përputhshmëri me kërkesat e raportimit financiar të "Rregullave dhe Rregulloreve" të përmendura më sipër. Si rezultat i kësaj, pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për ndonjë qëllim tjetër.

Raporti ynë i auditimit ka për qëllim vetëm për informim dhe përdorim të Bankës dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nuk duhet të përdoret nga palë të tjera përveç Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Opinioni ynë nuk është modifikuar për sa i përket kësaj çështjeje.

### Çështje tjera

Banka përgatit një paketë të veçantë të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për të cilat ne lëshojmë një raport të veçantë të auditimit për aksionarët e Bankës. Ne kemi lëshuar një opinion të pamodifikuar mbi këto të pasqyra të veçanta financiare më 29 mars 2018.

**Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave që janë të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare**  
Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me rregullat dhe rregulloret e BQK-së, dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, goftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likuideojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, goftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Menaxhmenti.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Türkiye İş Bankası A.Ş. - DEGA NË KOSOVË, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

*Ernst & Young Certified Auditors Kosovo*

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k

20 prill 2018

Prishtinë, Kosovë



**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro)*

	Shënime	<u>Më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Më 31 dhjetor 2016</u>
<b>Pasuritë</b>			
Paraja në bankë dhe balanca me Bankën Qendrore	7	19,006,820	14,276,905
Investime në letra me vlerë	8	620,199	4,645,875
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	9	79,282,319	54,491,314
Pronat dhe pajisjet	10	688,453	832,667
Pasuritë e paprekshme	11	47,015	56,770
Pasuritë tatimore te shtyra	25	64,782	-
Parapagimet e tatimit në të ardhura	25	12,840	-
Pasuritë tjera	12	5,769	4,767
<b>Totali i pasurive</b>		<b><u>99,728,197</u></b>	<b><u>74,308,298</u></b>
<b>Detyrimet</b>			
Depozitat nga klientët	13	42,808,947	30,914,346
Huazimet afatshkurtëra	14	5,525,602	7,905,295
Huazime nga kompania mëmë	15	42,186,943	25,146,612
Detyrime tjera tatimore afatshkurtëra	16	21,168	32,444
Të hyrat e shtyra	17	23,816	38,375
Detyrime tjera	18	88,595	65,802
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b><u>90,655,072</u></b>	<b><u>64,102,874</u></b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar		10,000,000	10,000,000
Humbjet e akumuluar		(926,875)	205,424
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>		<b><u>9,073,125</u></b>	<b><u>10,205,424</u></b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar</b>		<b><u>99,728,197</u></b>	<b><u>74,308,298</u></b>

Këto pasqyra financiare janë përgatitur nga Deloitte Kosova sh.p.k dhe janë aprovuar me 30 mars 2018 nga:

  
**Alper Karakoc**  
 Menaxher i degës  
 Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë

  
**Teuta Rexhbecaj**  
 Drejtoreshë financiare

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 37 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të hyrat nga interesi		4,327,174	3,530,730
Shpenzimet e interesit		(1,246,969)	(1,039,733)
<b>Të hyrat neto nga interesi</b>	<b>20</b>	<b>3,080,205</b>	<b>2,490,997</b>
Të hyrat nga tarifrat dhe komisionet		305,436	193,643
Shpenzimet e tarifave dhe të komisioneve		(13,225)	(29,710)
<b>Të hyrat neto nga tarifrat dhe komisionet</b>	<b>21</b>	<b>292,211</b>	<b>163,933</b>
Fitimi/(humbja) neto nga kursi valutor	<b>22</b>	152,258	(56,465)
Të hyrat tjera		25,522	15,749
<b>Totali i të hyrave operative</b>		<b>177,780</b>	<b>(40,716)</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Provizionet për humbjet nga kreditë	<b>9</b>	(2,631,270)	279,643
Provizionet për garancione kundrejt klientëve		(4,489)	13,091
Shpenzimet tjera operative	<b>23</b>	(844,777)	(714,820)
Përfitimet e punonjësve	<b>24</b>	(882,747)	(817,154)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	<b>10,11</b>	(178,569)	(167,766)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(4,541,852)</b>	<b>(1,407,006)</b>
<b>Fitimi / (Humbja) para tatimit</b>		<b>(991,656)</b>	<b>1,207,208</b>
Tatimi mbi fitim	<b>25</b>	64,782	(122,269)
<b>Fitimi (humbja) neto e vitit</b>		<b>(926,875)</b>	<b>1,084,939</b>
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Total të hyrat (humbjet) gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>(926,875)</b>	<b>1,084,939</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 37 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro)*

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Fitimet e mbajtura/(Humbj et e akumuluar)</b>	<b>Totali i kapitalit aksionar</b>
<b>Gjendja me 1 janar 2016</b>	<b>10,000,000</b>	<b>(879,515)</b>	<b>9,120,485</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>			
Fitimi neto për vitin	-	1,084,939	1,084,939
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>10,000,000</b>	<b>205,424</b>	<b>10,205,424</b>
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2016</b>	<b>10,000,000</b>	<b>205,424</b>	<b>10,205,424</b>
<b>Balanca me 1 janar 2017</b>	<b>10,000,000</b>	<b>205,549</b>	<b>10,205,549</b>
Fitimi neto për vitin	-	(926,875)	(926,875)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>10,000,000</b>	<b>(721,326)</b>	<b>9,278,674</b>
<b>Transaksionet me pronarët, të njohura direkt në ekuitet</b>			
<i>Kontributet nga dhe shpërndarjet për pronarët</i>	-	(205,549)	(205,549)
Kapitali i paguar nga Is Bankasi Turkiye A.S.	-	-	-
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2017</b>	<b>10,000,000</b>	<b>(926,875)</b>	<b>9,073,125</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 37 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
<b>I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi/(humbja) para tatimit		(991,656)	1,207,208
<b>Rregullimet për:</b>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	178,569	167,766
Provizionet e kredive të dyshimta		2,635,759	(292,734)
Të hyrat nga interesit	20	(4,327,174)	(3,530,730)
Shpenzimet e interesit	20	1,246,969	1,039,733
<b>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</b>			
Lëvizja në rezervën e detyrueshme me BQK-në	7	(3,000,000)	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	9	(27,389,621)	(12,230,675)
Depozitat nga klientët	13	11,771,815	11,092,078
Detyrimet tatimore afatshkurtëra dhe detyrime tjera	16,18	7,154	(99,886)
Të hyrat e shtyra		(14,559)	(13,708)
Pasuritë tjera	12	(1,002)	10,414
Tatimi në të ardhura i paguar		(19,830)	(2,324)
Interesi i paguar		(1,118,966)	(961,645)
Interesi i arkëtuar		4,318,448	3,513,870
<b>Paraja neto e përdorur për aktivitetet operative (I)</b>		<b>(16,704,094)</b>	<b>(100,633)</b>
<b>II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>			
Investimet në letra me vlerë	8	4,008,737	5,087,308
Blerjet e pronës dhe pajisjeve	10	(24,600)	(92,673)
Blerjet e pasurive të paprekshme	11	-	(22,312)
<b>Paraja neto e përdorur për aktivitetet investuese (II)</b>		<b>3,984,137</b>	<b>4,972,323</b>
<b>III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>			
Huazimet nga kompania mëmë	15	17,055,421	(1,533,004)
Huazimet afatshkurtëra	14	(2,400,000)	2,900,000
Dividendat e paguara		(205,549)	
<b>Paraja neto nga aktivitetet financuese (III)</b>		<b>14,449,872</b>	<b>1,366,996</b>
<b>IV. Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj (I+II+III)</b>		<b>1,729,915</b>	<b>6,238,686</b>
<b>V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit</b>	7	<b>10,276,905</b>	<b>4,038,219</b>
<b>VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit (IV+V)</b>	7	<b>12,006,820</b>	<b>10,276,905</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 37 në vijim janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



# **Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**

## **PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

### **1. ENTITETI RAPORTUES**

Türkiye İş Bankası A.Ş. – Dega në Kosovë ("Banka" ose "Dega") është një degë e Türkiye İş Bankası A.Ş., një entitet turk. Banka operon si bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës.

Banka operon nën licencën bankare Nr. 011 të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Dega është regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë më 19 nëntor 2012 dhe ka numër biznesi 70899345 si dhe numër fiskal 600886131. Gjatë vitit 2017, Banka ka operuar me dy zyre. Një zyrë gjendet tek rr.UÇK, 43 në Prishtinë ndërsa tjetra në Prizren tek rruga Zahir Pajaziti.

### **2. BAZAT E PËRGATITJES**

#### **(a) Deklaratë e pajtueshmërisë**

Banka ruan të dhënat e kontabilitetit dhe përgatit pasqyrat financiare siç parashihet me ligj në përputhje me parimin e koston historike dhe sipas udhëzimeve dhe rregullave të Bankës Qendrore të Kosovës ("Udhëzimet e BQK-së") të cilat janë të zbatueshme për Bankën. Udhëzimet e BQK-së bazohen në vendimet përkatëse ligjore që përcaktojnë zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") në Kosovë dhe kërkesat e tjera specifike, sidomos për provizionimin për rënien në vlerë nga huatë dhe pasuritë financiare. Këto kërkesa specifike nuk janë në përputhje me ato të SNRF në këtë aspekt dhe pasqyra financiare nuk duhet të lexohet si e përgatitur në përputhje me SNRF.

#### **(b) Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### **(c) Parimi i vijimësisë**

Menaxhmenti i bankës ka bërë një parashikim mbi aftësinë e bankës për vazhduar me parimin e vijimësisë dhe është e kënaqur që ka burimet për të vazhduar biznesin për të ardhmen e parashikueshme. Gjithashtu, menaxhmenti nuk është i informuar për ndonjë paqartësi materiale që mund të hedhë dyshime serioze mbi aftësinë e bankës për të vazhduar me parimin e vijimësisë. Si rrjedhojë, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

#### **(d) Valuta funksionale dhe e prezentimit**

Pasqyrat financiare janë prezentuar në Euro, që është edhe valuta funksionale e bankës.

#### **(e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me udhëzimet e BQK-së dhe parimet e SNRF kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, shpalosjet e pasurive dhe detyrimeve në grup në datën e pasqyrave financiare dhe shifrat e të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara gjatë periudhës raportuese. Megjithatë këto vlerësime bazohen në njohuritë më të mira të ngjarjeve dhe veprimeve aktuale, rezultatet mund të jenë të ndryshme nga ato vlerësime. Shifrat reale krahasuese të paraqitura në këto pasqyra financiare janë në Euro.

## **Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**

### **PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL**

Politikat kontabël të paraqitura në vijim janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezentuara në këto pasqyra financiare.

#### **(a) Transaksionet në valutë të huaj**

Transaksionet në valutë të huaj përkthehen në valutën funksionale sipas normave të këmbimit të datës së transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare të denominuara në valuta të huaja në datën e raportimit ripërkthehen në valutën funksionale sipas normës së këmbimit në atë datë. Pasuritë dhe detyrimet jomonetare të denominuara në valuta të huaja të cilat maten sipas vlerës së drejtë, përkthehen në valutën funksionale sipas normës së këmbimit në datën në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat nga valuta e huaj që dalin nga ripërkthimi njihen si fitim ose humbje.

#### **(b) Të hyrat dhe shpenzimet e interesit**

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila saktësisht diskonton pagesat dhe pranimet e vlerësuara të parave në të ardhmen përgjatë jetëgjatësisë së pritshe të pasurisë ose detyrimit financiar (ose nëse është e përshtatshme, një periudhe më të shkurtë) deri te vlera bartëse e pasurisë ose detyrimit financiar. Në kalkulimin e normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhën e ardhshme të parasë duke konsideruar të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo edhe humbjet e ardhshme kreditore.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshinë të gjitha kostot e transaksionit, tarifat dhe pikët e pranuar ose paguara të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto rritëse që i atribuohen direkt blerjes, lëshimit ose heqjes nga përdorimi të një pasurie ose detyrimi financiar.

Të hyrat dhe shpenzimet e interesit të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë interesin në pasuritë dhe detyrimet financiare të matura sipas koston së amortizuar dhe të kalkuluara sipas normës efektive të interesit.

#### **(c) Tarifat dhe komisionet**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një pasurie financiare ose detyrimi financiar, përfshihen në kalkulimin e normës efektive të interesit.

Të ardhurat tjera nga tarifat dhe komisionet - përfshijnë tarifat e shërbimeve të llogarive, komisionet e shitjeve, tarifat e plasmaneve-njihen kur kryhen shërbimet e ndërlidhura me to. Nëse zotimi për kredi nuk pritet të rezultojë në dhënie dhe tërheqjen e kredisë, atëherë tarifat e ndërlidhura me zotimin e kredisë njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së zotimit.

Shpenzime tjera të tarifave dhe komisioneve ndërlidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat janë shpenzime në momentin që shërbimet pranohen.

#### **(d) Shpenzimet e tatimit në të ardhura**

Shpenzimet e tatimit në të ardhura përbëhen nga tatimet afatshkurtëra dhe tatimi i shtyrë. Shpenzimet e tatimit në të ardhura njihen në fitim ose humbje deri në masën që një zë njihet direkt në ekuitet ose në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse.

##### *Tatimi aktual*

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi që pritet të jetë i pagueshëm apo i arkëtueshëm në të ardhurat ose humbjet e tatueshme të vitit dhe çfarëdo rregullimi të tatimit të pagueshëm apo të arkëtueshëm nga vitet e kaluara. Llogariten në bazë të normave tatimore në fuqi ose që kanë hyrë në fuqi në datën e raportimit.

##### *Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet duke llogaritur diferencat e përkohshme në mes të vlerave bartëse të pasurive dhe detyrimeve për qëllim të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime të tatimit.

Tatimi i shtyrë matet sipas normave të tatimit që pritet të zbatohen në diferencat e përkohshme kur të kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që kanë hyrë në fuqi në mënyrë thelbësore në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë njihet si pasuri vetëm deri në atë masë që në të ardhmen do të ketë fitime të mundëshme të tatueshme në dispozicion kundrejt të cilës mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme.

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

**3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

**d) Shpenzimet e tatimit në të ardhura (vazhdim)**

*Tatimi i shtyrë*

Detyrimet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Tatimi i shtyrë si pasuri dhe tatimi i shtyrë si detyrim rishikohen në secilën datë raportuese dhe zvogëlohen deri në atë masë që nuk është e mundshme që një përfitim tatimor, respektivisht një obligim tatimor, do të realizohet. Tatimi shtesë në të ardhura nga shpërndarja e dividendave njihet në të njëjtën kohë kur njihen edhe detyrimet për të paguar dividendin.

**(e) Lizingjet operative**

Pagesat e bëra nën lizing operativ i ngarkohen shpenzimeve në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e lizingut.

**(f) Pasuritë dhe detyrimet financiare**

*(i) Njohja*

Njohja e kredive dhe paradhënieve, depozitave dhe detyrimeve tjera bëhet në datën kur këto krijohen. Të gjitha instrumentet tjera financiare (përfshirë blerjet e rregullta dhe shitjet e pasurive financiare) njihen në datën e tregtimit, datën në të cilën Banka merr përsipër kushtet kontraktuale të instrumenteve.

Një pasuri apo detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e saj, për një zë me vlerë jo të drejtë përmes fitimit ose humbjes.

*(ii) Klasifikimi*

**Pasuritë financiare**

Banka i klasifikon pasuritë financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- huatë dhe të arkëtueshmet;
- të mbajtura deri në maturim.

Referohu shënimeve 3(g) deri te 3(h).

**Detyrimet financiare**

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, përveç garancioneve financiare dhe zotimeve për kredi, të matura në koston e amortizuar. Referohu 3(j).

*(iii) Mosnjohja*

**Pasuritë financiare**

Banka çregjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuritë financiare mbarojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse monetare kontraktuale në një transaksion me të cilin kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar, ose në të cilën Banka as nuk transferon e as nuk ruan të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk e mban kontrollin e pasurisë financiare.

Në çregjistrimin e një pasurie financiare, diferenca në mes vlerës së mbetur të pasurisë (ose vlerës së mbetur të ndarë në pjesën e pasurisë së çregjistruar) dhe shumën e (i) për konsideratën e pranuar (përfshirë çdo pasuri të re të përfituar zvogëluar me çdo detyrim të ri të vlerësuar) dhe (ii) çdo fitimi ose humbje kumulative që është njohur në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse, njihet në fitim ose humbje. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për mosnjohje që përfitohet ose mbahet nga Banka njihet si një pasuri apo detyrim i veçantë.

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbyshur, ndërprerë, ose kanë skaduar.

*(iv) Netimi*

Pasuritë dhe detyrimet financiare thyhen në mes vete dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozitës financiare atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtë ligjore për thyerjen e shumave me qëllim që thyerja të bëhet në baza neto ose thyerja të realizohet njëkohësisht për pasuritë dhe detyrimet.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga SNRF.

## **Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**

### **PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

##### *(v) Matja sipas kostos së amortizuar*

"Kostoja e amortizuar" e një pasurie apo detyrimi financiar është vlera me të cilën pasuria financiare ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën efektive të interesit të çdo diference ndërmjet shumës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për dëmtim.

##### *(vi) Matja sipas vlerës së drejtë*

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të mirret për të shitur një pasuri ose që do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt në mes të pjesëmarrësve të tregut në parim në datën e matjes ose, në mungesë të saj, në tregun më të favorshëm për të cilat Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron riskun e saj të mosperformancës.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmim të kuotuar në një treg aktiv për atë instrument atëherë kur këto rrethana ekzistojnë. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet për pasuritë dhe detyrimet zhvillohen me frekuencë dhe volum të mjaftueshëm që të ofrojnë informata të çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse vëzhguese dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshinë të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit pra vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë.

Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një pasuri ose detyrim identik dhe as në bazë të një teknike vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e mbikëqyrura, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë ndryshimin midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit e transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi është mbështetur plotësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose transaksioni është i mbyllur. Në qoftë se një pasuri ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim ofertues dhe një çmim kërkese, atëherë Banka mat pasuritë dhe pozicionet afatgjata në çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet afatshkurtëra në një çmim kërkese.

Vlera e drejtë e një depozite rrjedhëse nuk është më pak se shuma e pagueshme për këtë, diskontuar nga data e parë në të cilën shuma mund të kërkohet për t'u paguar. Banka njeh transferet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

##### *(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë*

#### **Rënia në vlerën e kredive dhe paradhënieve**

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që pasuritë financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes kanë pësuar rënie në vlerë. Një pasuri ose një grup pasurish financiare pësojnë rënie në vlerë kur ka evidenca objektive që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë, dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhat e ardhshme të parasë së pasurisë që mund të matet në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që pasuritë financiare kanë rënë në vlerë mund të përfshijë vështirësi të konsiderueshme financiare të huamarrësit ose emetuesit, mospagesa apo vonesa nga huamarrësi, ristrukturimi i kredisë dhe paradhënieve nga Banka me kushte që Banka nuk do kishte konsideruar më herët, të dhënat që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, humbja e një tregu aktiv për letra me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup pasurish të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesit në grup, apo kushtet ekonomike që lidhen me sjelljen joperformuese në grup.

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

**3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

**f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

***Rënia në vlerën e kredive dhe paradhëniet***

Metoda bazë e përdorur për llogaritjen e provizioneve kolektive të kredive është “modelimi i sjelljes së mëparshme të klientëve” (në vëllime të grumbulluara). Ky model bazohet në koeficientët e ashtuquajtur ‘roll-rate’ nga të cilët llogariten me mesatare historike.

Dega llogaritë normat aktuale të vonesave vjetore për kreditë aktuale gjatë 12 muajve të fundit dhe zbaton këto norma ndaj riskut neto (duke zbritur kolateralin e pranueshëm në para – cash collateral) të kredive aktuale në baza mujore. Banka kryen analiza të normave të rrotullimit veç e veç për kredi dhe garancione.

Metoda mesatare historike është një qasje e thjeshtuar që përdoret për të plotësuar modelin ‘Roll Rate’. Metoda mesatare historike ofron një vlerësim të mesatare vjetore bazuar në ecurinë e kaluar.

Koeficienti mesatar i fundit historik për klasifikimet “Standarde” dhe “Vrojtuese” është i kufizuar deri në raportin e klasifikimit Nën-standarde.

Provizonet e krijuara për humbjet e mundshme të kredive dhe paradhëniet të klasifikuara si “standarde” dhe “vrojtuese” klasifikohen si provizione të përgjithshme. Për çdo kategori rreziku zbatohen normat minimale të dispozitës specifike në vijim.

<b>Strategjia e Riskut</b>	<b>Provizioni i humbjeve (rregullorja e BQK-së)</b>	<b>Provizioni i humbjeve të aplikuar nga Banka</b>
Standarde	Asnjë minimum	Modeli ‘Roll rate’
Vrojtuese	Asnjë minimum	Modeli ‘Roll rate’
Nën-standarde	Minimum 20%	20%
Të dyshimta	Minimum 50%	50%
Në humbje	100%	100%

‘Roll rate’ për kategorinë Standarde në vitin 2017 është 0.13% (2016: 0.05%) ndërsa për kategorinë Vrojtuese në vitin 2017 është 12% (2016: 8.32%). Banka konsideron evidencën e rënies në vlerë për kreditë dhe paradhëniet dhe letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim, specifikisht për pasuri dhe në një nivel kolektiv. Ato që nuk janë të provizionuara specifikisht, vlerësohen kolektivisht për çdo rënie në vlerë që ka ndodhur por nuk është identifikuar ende.

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **(f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

##### ***Rënia në vlerën e kredive dhe paradhëniet (vazhdim)***

Kreditë dhe paradhëniet dhe letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim që nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen kolektivisht për rënie në vlerë duke u grupuar së bashku kreditë dhe paradhëniet dhe letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim me karakteristika të ngjashme të riskut.

Humbjet nga rënia në vlerë e pasurive të matura me koston e amortizuar llogariten si diferenca midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhave të ardhshme të parasë të parashikuara, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë.

#### **(g) Kreditë dhe paradhëniet**

Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Huatë dhe paradhëniet për bankat dhe huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve klasifikohen si hua dhe të arkëtueshme.

Të gjitha kreditë dhe paradhëniet njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare, këto maten më pas me kostot e amortizuara duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh kostot e lëshimit dhe çdo zbritje ose shpërblim për shlyerjen.

Huatë dhe paradhëniet raportohen neto nga provizionet për humbjet nga kreditë.

#### **(h) Investimet e mbajtura deri në maturim**

Investimet e mbajtura deri në maturim janë pasuri jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe maturim fiks që Banka ka synimin dhe aftësinë pozitive për të mbajtur deri në maturim dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të disponueshme- për shitje.

Investimet e mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga rënia në vlerë. Një shitje ose riklasifikim i një shume më të vogël se investimet e mbajtura deri në maturim do të rezultonte në riklasifikimin e të gjitha investimeve të mbajtura deri në maturim si të vlefshme për shitje dhe do të parandalonte Bankën nga klasifikimi i letrave me vlerë të investimit si të mbajtura - maturimi për vitet aktuale dhe dy vitet e ardhshme financiare.

#### **(i) Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë shënimet dhe monedhat në dorë, bilancet e pakufizuara të mbajtura me bankat qendrore dhe pasuritë financiare shumë likuide me maturitet fillestare prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që i nënshtrohen një risku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë të përdorura nga Banka në menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbarten me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

#### **(j) Depozitat dhe huazimet**

Depozitat dhe huazimet janë burimet kryesore të Bankës për financimin e borxhit.

Depozitat dhe huamarrjet fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit direkt të rritjes dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### **(k) Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që benifitet ekonomike do të kërkohen për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke diskontuar vlerën e ardhshme të parasë me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike ndaj detyrimit. Lëshimet e diskontimit njihen si kosto financiare.



## **Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**

### **PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **(l) Përfitimet e punonjësve**

*(i) Kontributet e obligueshme të sigurimit shoqëror*

Banka bën vetëm pagesa të kontributeve të obligueshme që ofrojnë përfitim të pensionit për punonjësit pasi të pensionohen. Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për të ofruar minimumin e pensionit të Kosovës sipas planit të definuar të pensionit. Kontributet e Bankës në planin pensional ngarkohen në fitim ose humbje në momentin e ndodhjes.

*(ii) Pushimi i paguar vjetor*

Banka njih si detyrim shumë të padiskontuar të kostove të vlerësuara që kanë të bëjnë me pushimin vjetor që pritet të paguhet në këmbim për shërbimet e punonjësve në periudhën e përfunduar.

#### **(m) Pronat dhe pajisjet**

*(i) Njohja dhe matja*

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë paraqitur sipas kostos minus zhvlerësimit të akumuluar dhe humbjeve nga dëmtimet. Kosto përfshinë shpenzimet të cilat i atribuohen direkt blerjes së pasurisë.

Kur pjesët e një zëri të pronës, pronës dhe pajisjeve kanë jetë të ndryshme të përdorimit, ato trajtohen si zëra të veçantë (komponenta kryesore) të pronës dhe pajisjeve.

Një zë i pronës dhe pajisjeve çregjistrohet në rast se shitet ose kur nuk ka përfitime të ardhme ekonomike që pritet të lindin nga përdorimi i vazhdueshëm i pasurisë. Çdo fitim ose humbje që lind me rastin e shitjes së një zëri të pronës, impianteve dhe pajisjeve, përcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të pasurisë, dhe njihet në fitim ose humbje.

*(ii) Kostot pasuese*

Kosto e zëvendësimit të një pjese të pronës dhe pajisjeve njihet sipas vlerës bartëse të zërit nëse përfitimi i ardhshëm ekonomik i integruar brenda pjesës së pasurive është i mundshëm të rrjedhë në kompani dhe kosto e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të pronës dhe pajisjeve nga dita në ditë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ato ndodhin.

*(iii) Zhvlerësimi*

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas metodës lineare përgjatë jetës së vlerësuar të përdorimit të pasurive. Metodatat e zhvlerësimit, jetët e përdorimit dhe vlerat e mbetura (nëse nuk janë domethënëse) rivlerësohen në datën e raportimit.

Jetët e vlerësuara të përdorimit për periudhat e tanishme dhe krahasuese ishin siç vijon:

- |                                |        |
|--------------------------------|--------|
| • Pajiset dhe mobilet e zyrës  | 5 vite |
| • Pasuritë tjera joqarkulluese | 5 vite |
| • Automjetet                   | 5 vite |

Përmirësimet e objekteve me qira zhvlerësohen në afatin e qirasë apo jetës së tyre të dobishme, varësisht se cila është më e shkurtër (10 vjet).

#### **(n) Pasuritë e paprekshme**

Pasuritë e paprekshme me jetë të caktuar të përdorimit dhe të cilat janë blerë ndaras njihen sipas kostos minus amortizimit të akumuluar dhe humbjeve nga dëmtimet. Amortizimi njihet duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të pasurisë. Jeta e përdorimit dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të secilës datë të raportimit, ndërsa çfarëdo ndryshimi ka efekt dhe merret parasysh për të ardhmen.

Jeta e dobishme e softuerit është pesë vjet.

Pasuritë e paprekshme me jetë të pacaktuar të përdorimit dhe të cilat janë blerë ndaras njihen sipas kostos minus humbjeve nga dëmtimet.

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **(o) Donacionet**

Donacionet nuk njihen derisa ekziston siguria e arsyeshme që Banka do të përmbushë kushtet bashkangjitur me to dhe se donacionet do të pranohen. Donacionet njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në baza sistematike përgjatë periudhës kur Banka njih shpenzimet të cilat mbulohen nga donacioni. Në mënyrë specifike, donacionet njihen si të hyra të shtyra në pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare dhe transferohen në fitim ose humbje në mënyrë sistematike dhe racionale përgjatë jetës së dobishme të pasurisë së dhuruar.

#### **(p) Garancionet financiare dhe zotimet e kredive**

Garancionet financiare janë kontrata të cilat kërkojnë nga Banka që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar poseduesin për ndonjë humbje që mund të ndodhë për shkak të dështimit për të paguar ndonjë huamarrës i caktuar në përputhje me kushtet e instrumentit të huamarrjes. Zotimet për kreditë janë zotime të Bankës që të ofrojë kredi në përpudhshmëri me afatet dhe kushtet e paracaktuara. Zotimet e tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozitës financiare nëse dhe atëherë kur bëhen të pagueshme.

#### **(q) Tatimimi**

Tatimi i tanishëm mbi të ardhurat kalkulohet në bazë të rregulloreve të aplikueshme në Kosovë mbi tatimin në të ardhura, duke përdorur normat tatimore të miratuara me datë të pozicionit financiar. Norma tatimore prej 10% në të ardhurat e korporatave është efektive prej 1 shtatorit 2015 në përputhje me rregulloret e tatimeve të Kosovës që janë në fuqi, përkatësisht, Ligji Nr. 05/L-029 “Tatimi mbi të ardhurat nga korporatat”. Tatimi i ngarkuar në fitimin dhe humbjen vjetore përfshinë, tatimin për periudhën përkatëse dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë. Tatimi i tanishëm kalkulohet në bazë të fitimit vjetor të tatueshëm që parashihet të ndodhë, duke i përdorur normat tatimore në fuqi apo që janë buzë miratimit me datë të pozicionit financiar.

Profiti i tatueshëm dallon nga profiti i raportuar në pasqyrën e fitimit dhe humbjes sepse përjashton pjesë të të hyrave apo shpenzimeve të cilat janë të tatueshme apo të zbritshme në vitet tjera, njëkohësisht, përjashton ato pjesë të të hyrave apo shpenzimeve që nuk janë kurrë të tatueshme apo të zbritshme. Tatimet e tjera, përveç atyre mbi të ardhurat, përfshihen tek shpenzimet operative.

Tatimi i shtyrë mbi të ardhurat llogaritet sipas metodës së paraqitjes si detyrim në pozicionin financiar për diferencat e përkohshme që mund të shfaqen ndërmjet bazës tatimore të pasurive dhe detyrimeve dhe vlerës së tyre për qëllime të raportimit. Pasuritë e tatimeve të shtyra njihen deri në masën që profiti i tatueshëm në të ardhmen do të jetë në dispozicion kundrejt të cilit këto diferencat të përkohshme mund të përdoren. Pasuritë e tatimit të shtyrë zvogëlohen deri në masën kur nuk është më e mundshme që përfitimi tatimorë në fjalë nuk mund të realizohet. Pasuritë dhe detyrimet e shtyra tatimore maten me normat tatimore të cilat priten të aplikohen në periudhën kur pasuria realizohet apo detyrimi është vendosur bazuar në normat tatimore që janë në fuqi apo janë buzë miratimit me datë të pozicionit financiar. Pasuritë dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen kur e drejta e fuqizuar ligjrisht është miratuar me datë të pozicionit financiar.

#### **(r) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime të SNRF-ve që mund të ndikojnë në kornizën e BQK-së për përgatitjen e pasqyrave financiare**

Një numër i standardeve të reja, ndryshimeve apo interpretimeve të tyre nuk janë efektive për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017 dhe nuk janë aplikuar në përpilimin e pasqyrave financiare. Ato të cilat janë relevante për Bankën janë përshkruara më poshtë. Banka nuk planifikon të zbatojë këto standarde dhe ndryshimet e tyre paraprakisht.

##### **SNRF 9 Instrumentet Financiare**

SNRF 9 zëvendëson SNK 39 për periudhat vjetore më ose pas 1 janarit 2018. SNRF 9 do të ndikojë ndjeshëm në industrinë bankare në aspektin e mënyrës së klasifikimit dhe matjes së pasurive dhe detyrimeve financiare dhe më e rëndësishmja se si matet rënia në vlerë, me kalimin nga modeli i “humbjet e ndodhura” në modelin e humbjeve të pritura.

Kërkesat për rënie në vlerë të SNRF 9 nuk janë të zbatueshme për qëllime të raportimit sipas kornizës së BQK-së, meqë BQK-ja ka rregullat e veta të rënies në vlerë siç shpallen në seksionin 3 f) më lart.

## **Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**

### **PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*

*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

SNRF 9 gjithashtu do të prezantojë ndryshime në lidhje me mënyrën se si pasuritë dhe detyrimet financiare do të klasifikohen dhe maten siç shpalosen më poshtë.

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **(r) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime të SNRF-ve që mund të ndikojnë në kornizën e BQK-së për përgatitjen e pasqyrave financiare (vazhdim)**

##### ***SNRF 9 Instrumentet Financiare (vazhdim)***

###### ***Ndryshimet në klasifikim dhe matje***

Për të përcaktuar kategorinë e tyre të klasifikimit dhe matjes, SNRF 9 kërkon që të gjitha pasuritë financiare, përveç instrumentave të kapitalit dhe derivativëve, të vlerësohen në bazë të një kombinimi të modelit të biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e pasurive dhe karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të instrumenteve.

Kategoritë e matjes së pasurive financiare të SNK 39 (vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVPL), të vlefshme për shitje (AFS), të mbajtura deri në maturim dhe kosto e amortizuar) janë zëvendësuar me:

- Instrumentet e borxhit me koston e amortizuar
- Instrumentet e borxhit me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse (FVOCI), me fitime ose humbje të ricikluara në fitim ose humbje për çregjistrimin
- Instrumentat e kapitalit në FVOCI, pa riciklimin e fitimeve ose humbjeve o fitim ose humbje për mosnjohje
- Pasuritë financiare FVPL

Aktualisht, Banka mat të gjitha pasuritë e saj financiare si të mbajtura deri në maturim dhe koston e amortizuar. Sipas SNRF 9, matja e koston së amortizuar mund të vazhdojë vetëm nëse plotësohen dy kushtet e mëposhtme:

- Pasuria financiare mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale
- Kushtet kontraktuale të pasurisë financiare përmbajnë rrjedhën e parasë e cila gjenerohet vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI) në shumën kryesore të principalit të paguar.

Banka Qendrore nuk ka marrë ndonjë vendim zyrtar nëse dhe si ka për qëllim të miratojë kërkesën e SNRF 9.

##### ***SNRF 16 Qiratë***

SNRF 16 është nxjerrë në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiradhënie, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një qira, KIS-15 Qiratë Operative-Nxitjet dhe KIS-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të qirasë dhe kërkon që qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm në bilanc, ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Standardi përfshin dy përjashtime njohjeje për qiramarrësit - dhënien me qira të pasurive "me vlerë të ulët" (p.sh. kompjuterët personalë) dhe qiratë afatshkurtra (dmth. me qera me një afat kohor me qira prej 12 muajsh ose më pak). Në datën e fillimit të një qiraje, një qiramarrës do të njohë një detyrim për të bërë pagesa të qirasë (dmth. Detyrimin e qirasë) dhe një pasuri që përfaqëson të drejtën e përdorimit të pasurise bazë gjatë afatit të qirasë (p.sh. pasurinë e së drejtës së përdorimit).

Qiradhënësi do të kërkohet të njoh veçmas shpenzimet e interesit në detyrimet e qirasë dhe shpenzimet e amortizimit në pasurinë e të drejtës së përdorimit. Qiramarrësi gjithashtu do të kërkohet që të rimarrin detyrimin e qirasë me rastin e ngjarjeve të caktuara (p.sh. një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë të ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks apo normë të përdorur për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohë shumën e rivlerësimit të detyrimit të qirasë si një rregullim të pasurisë të së drejtës së përdorimit.

Kontabiliteti qiramarrësit sipas SNRF 16 është në thelb i pandryshuar nga kontabilizimi i sotëm sipas SNK 17, megjithatë Banka nuk është qiradhënëse.

SNRF 16 është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Sidoqoftë, ende nuk është e qartë nëse ky standard, i cili ndikon dukshëm në mënyrën e llogaritjes së qirasë, do të miratohet në kuadër të BQK-së. Detyrimet e qirasë sipas SNRF 16 mund të jenë të rëndësishme në varësi të vlerës së qirasë dhe të kohëzgjatjes së prituri të kontratave të qirasë, si rrjedhim mund të ndikojë në mënyrën se si llogariten mjaftueshmëria e kapitalit dhe kufijtë e tjerë rregullatorë. Rrjedhimisht, një adaptim formal i standardit nga BQK-ja mund të kërkohet para se Banka të miratojë standardin në këto pasqyra financiare.

## **Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**

### **PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*

*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

Banka ka me qira hapësirat e saj të zyrave me shumën bruto totale në muaj prej 10,220 Euro. Banka është duke vlerësuar ndikimin e SNRF 16. Pagesat e pa skontuara të qirasë operationale sipas kontratave të qirasë të padisponueshme shpalosen në shënimin 27.

### **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **(r) Standarde të reja, ndryshime dhe interpretime të SNRF-ve që mund të ndikojnë në kornizën e BQK-së për përgatitjen e pasqyrave financiare (vazhdim)**

##### ***SNRF 17 Kontratat e Sigurimit***

SNRF 17 është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021. Ky standard nuk ndikon në Bankë

##### ***SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët***

SNRF 15 krijon një kuadër gjithëpërfshirës për të përcaktuar nëse, sa dhe kur të ardhurat njihen. Ai zëvendëson standardet ekzistuese për njohjen e të ardhurave, duke përfshirë IAS 18 Të Ardhurat, SNK 11 Kontratat e Ndërtimit dhe IFRIC 13 Programet e Besnikërisë së Konsumatorëve. SNRF 15 është efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018. Banka vlerëson ndikimin e mundshëm në pasqyrat financiare të saj që rrjedhin nga zbatimi i SNRF 15, megjithatë duke qenë institucion financiar, të ardhurat e saj përgjithësisht jashtë fushëveprimit të SNRF 15.

##### ***Ndryshimet e SNRF 2 Pagesat e Bazuara ne Aksione***

Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018. Ky standard nuk ndikon në Bankën.

##### ***Ndryshimet e SNRF 4 Kontratat të Sigurimit***

Aplikimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018 ose kur SNRF 9 Instrumentet Financiare zbatohet për herë të parë. Ky standard nuk ndikon në Bankën.

##### ***Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare"***

Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

##### ***Ndryshimet e SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në Oratakëri dhe Shoqëritë Aksionare***

Shitja ose Kontributi i Pasurive në mes të një Investitori dhe Shoqatës së tij ose Sipërmarrjes së Përbashkët dhe ndryshimet e mëtejshme datën e saj efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar derisa të përfundohet projekti hulumtues mbi metodën e kapitalit. Ky standard nuk ndikon në Bankën.

##### ***Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"***

Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Ky standard nuk ndikon në Bankën.

##### ***Ndryshimet e SNK 40 Pronat Investive***

Transferimet e Pronës së Investimit janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018. Standardi nuk ndikon në Bankën.

##### ***Ndryshimet ne standardet e ndryshme – Përmirësimet e SNRF-së (cikli 2014-2016)***

Ndryshimet që rezultojnë nga projekti për përmirësimet vjetore të SNRF-së (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) posaqërisht, me synimin për të sqaruar mospërputhjet dhe formulimet. Ndryshimet e SNRF 12 do të aplikohen për periudhat që fillojnë me apo pas 1 janarit 2017 dhe ndryshimet e SNRF 1 dhe SNK 28 do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas 1 janarit 2018. Ky standard nuk ndikon në Bankën.

##### ***Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2015-2017)***

Ndryshimet që rezultojnë nga përmirësimi i përvitshëm të projektit të SNRF (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllimin që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2019). Ky standard nuk ndikon në Bankën.

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*

*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

**KISNRF 22 Transaksionet në Valuta të Huaja dhe Konsideratat e Paradhënieve**

Transaksionet në Valuta të Huaja dhe Konsideratat e Paradhënieve është efektive për periudhat vjetore më apo pas 1 janarit 2018.

**KIRFN 23 “Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat**

Pasiguria mbi trajtimin e tatimit mbi të ardhurat është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

**3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

- (s) **Ndryshimet e reja në vijim të standardeve ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) janë efektive për periudhën raportuese aktuale:**

***Ndryshimet e SNK 7 Pasqyra e Rrjedhës së Parë***

Iniciativa për Shpaloje është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017 (shih shënimin 5).

***Ndryshimet e SNK 12 Tatimet në të Ardhura***

Njohja e Pasurive Tatimore të Shtyra për Humbjet e Perealizuara është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017.

***Ndryshimet në SNRF 12 – Përmirësimet e SNRF-së (cikli 2014-2016)***

Ndryshimet që rezultojnë nga projekti për përmirësimet vjetore të SNRF-së (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) posaqërisht, me synimin për të sqaruar mospërputhjet dhe formulimet. Ndryshimet e SNRF 12 do të aplikohen për periudhat që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017 dhe ndryshimet e SNRF 1 dhe SNK 28 do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018. Ky standard nuk ndikon në Bankën.

- (t) **Riklasifikimi**

Kur është e nevojshme, shifrat e krahasueshme riklasifikohen për qëllime të krahasimit.

Shuma prej 20,439 Euro për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, më parë e përfshirë në “te hyrat e tjera nga tarifat dhe komisionet” në shënimin 21 është riklasifikuar në një linjë të vecantë në po të njëjtën shënim të quajtur “Të hyrat nga tarifa e disbursimit”.

#### **4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR**

Procesi i menaxhimit të riskut dhe funksionet e përfshira në këtë proces janë një nga përgjegjësitë kryesore të Bordit të Drejtorëve të kompanisë mëmë. Departamenti i Menaxhimit të Riskut, i cili vepron në kuadër të Bordit të Drejtorëve, është organizuar në Njësinë e Menaxhimit të Riskut së Pasurive-Detyrimeve, Riskut Kreditor si dhe Njësisë Ekonomike Kapitale, Risku Operacional dhe Verifikimi i Modeleve dhe Njësia e Riskut të Degëve.

Procesi i menaxhimit të riskut të Bankës është kryer në kuadër të politikave të riskut të cilat janë të vendosura nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut dhe të nxjerra nga Bordi i Drejtorëve dhe standardeve të shkruara të cilat përmbajnë standardet e politikave të riskut.

Këto politika të cilat kanë hyrë në fuqi në përputhje me praktikat ndërkombëtare janë standarde të përgjithshme që përmbajnë: organizimin dhe fushëveprimin e funksionit të menaxhimit të riskut, politikat e matjes së riskut, detyrat dhe përgjegjësitë e grupit të menaxhimit të riskut, procedurat për përcaktimin e limiteve të riskut, mënyrat për të eliminuar shkeljet e limiteve dhe miratimin, konfirmimin që duhet të jepet në një shumëllojshmëri të ngjarjeve dhe situatave. Fushëveprimi dhe përmbajtja e sistemit të menaxhimit të riskut të Bankës është dhënë nga llojet kryesore të riskut.

Banka i ekspozohet risqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- risku kreditor
- risku i likuiditetit
- risku i tregut
- risku operacional

Ky shënim paraqet informacione rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit nga risqet më lartë, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e riskut si dhe menaxhimin e kapitalit nga Banka.

##### **(a) Risku kreditor**

Risku kreditor është risku i humbjeve financiare të bankës nëse klienti apo pala tjetër e një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe vjen kryesisht nga kreditë e bankës për klientët, bankat e tjera dhe investimeve.

Risku kreditor përcaktohet si risku i dështimit nga mosperformimi me kërkesat ose dështimi për të përmbushur detyrimet pjesërisht ose tërësisht nga ana e klientëve në kontratën e transaksionit me Bankën. Metodologjia dhe përgjegjësitë e menaxhimit të riskut kreditor, kontrollit dhe monitorimit si dhe korniza e limiteve të riskut kreditor janë të përcaktuara me politikën e riskut kreditor. Banka përcakton, mat dhe menaxhon riskun kreditor të të gjitha produkteve dhe aktiviteteve. Bordi i Drejtorëve i rishikon politikat dhe strategjitë e riskut kreditor minimum në baza vjetore. Menaxhmenti i Lartë është përgjegjës për zbatimin e politikave të riskut kreditor të cilat janë të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.

Si rezultat i kredive dhe analizave të riskut kreditor, të gjitha gjetjet i raportohen Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit të Lartë në baza të rregullta. Përveç transaksioneve dhe proceseve të vlerësimit të riskut kreditor, monitorimi i riskut kreditor i referohet poashtu edhe monitorimit dhe menaxhimit të kredive sipas sektorëve, sigurimit, gjeografisë, valutës, llojit të kredive si dhe vlerësimit kreditorë.

Në menaxhimin e riskut kreditor të Bankës, përveç limiteve siç kërkohet nga rregulloret ligjore, Banka përdorë edhe limitet e riskut për të ndërmarrë riskun maksimal të kreditor brenda grupeve të riskut ose sektorëve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve.

Këto limite janë vendosur në mënyrë të tillë që pengon koncentrimin e riskut në sektorë të veçantë. Limitet e riskut të tepërt deri të kërkesat ligjore si dhe kufinj të limiteve konsiderohen si një përjashtim. Bordi i Drejtorëve ka autoritet në procesin e përjashtimit. Rezultatet e kontrollit të limiteve të riskut dhe vlerësimet e këtyre limiteve janë paraqitur nga Auditori i Brendshëm dhe nga Grupi i Menaxhimit të Riskut tek Menaxhmenti i Lartë dhe Bordi i Drejtorëve.



**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*

*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

Banka përdorë sistemet e mbështetjes për vendimmarje të kreditit të cilat janë krijuar me qëllim të menaxhimit të riskut kreditor, vendimet e kreditimit, kontrollin e procesit të kreditimit dhe provizionimin për kreditë. Konsistenca e sistemeve të mbështetjes vendimmarëse të kredisë me strukturën e aktiviteteve të Bankës, madhësinë dhe kompleksitetin, shqyrtohet vazhdimisht nga sistemet e brendshme. Sistemet e mbështetjes për vendimmarje të kreditit përmbajnë vlerësimin e Komitetit të Riskut dhe aprovimin e Bordit të Drejtorëve.

**4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(a) Risku Kreditor (vazhdim)**

*Ekspozimi maksimal i kreditor*

Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor para kolateralit dhe rritjeve të tjera të kredisë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 është si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Balanca në Bankën Qendrore të Kosovës (referencë shënimi 7)	16,179,963	11,355,178
Paraja në banka (referencë shënimi 7)	2,262,181	2,208,972
Kreditë dhe paradhëniet për klientët, neto	79,282,319	54,491,314
Investimet në letra me vlerë	620,199	4,645,875
Garancionet në llogari të klientëve dhe zotimet për kreditë	12,159,228	12,110,437
<b>Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë</b>	<b>110,503,890</b>	<b>84,811,776</b>

Kualiteti i kredive sipas klasës së pasurive financiare

<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>As në vonesë e as të provizionuara</b>	<b>Në vonesë por jo të provizionuara</b>	<b>Në vonesë dhe të provizionuara</b>	<b>Gjithsej</b>
Balanca në Bankën Qendrore të Kosovës (referencë shënimi 7)	16,179,963	-	-	16,179,963
Paraja në banka (referencë shënimi 7)	2,262,181	-	-	2,262,181
Kreditë dhe paradhëniet për klientët, neto	78,468,883	225,365	588,071	79,282,319
Investimet në letra me vlerë	620,199	-	-	620,199
Garancionet në llogari të klientëve dhe zotimet për kreditë	12,159,228	-	-	12,159,228
<b>Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë</b>	<b>109,690,454</b>	<b>225,365</b>	<b>588,071</b>	<b>110,503,890</b>

<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>As në vonesë e as të provizionuara</b>	<b>Në vonesë por jo të provizionuara</b>	<b>Në vonesë dhe të provizionuara</b>	<b>Gjithsej</b>
Balanca në Bankën Qendrore të Kosovës (referencë shënimi 7)	11,355,178	-	-	11,355,178
Paraja në banka (referencë shënimi 7)	2,208,972	-	-	2,208,972
Kreditë dhe paradhëniet për klientët, neto	53,058,338	1,432,976	-	54,491,314
Investimet në letra me vlerë	4,645,875	-	-	4,645,875
Garancionet në llogari të klientëve dhe zotimet për kreditë	12,110,437	-	-	12,110,437
<b>Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë</b>	<b>83,378,800</b>	<b>1,432,976</b>	<b>-</b>	<b>84,811,776</b>

Kreditë dhe paradhëniet për klientët janë me norma fikse dhe variabile të interesit.

*Rënia në vlerë e kredive dhe letrave me vlerë*

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

---

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*

*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

Humbja e vlerës së kredive dhe letrave me vlerë bëhet për kreditë dhe letra me vlerë për të cilat Banka konstaton se ka një probabilitet që nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë principalin dhe interesin e duhur sipas kushteve kontraktuale të kredisë / instrumentit.

*Kreditë në vonesë për të cilat nuk llogaritet humbje nga rënia në vlerë*

Kreditë dhe letrat me vlerë, ku interesi kontraktual ose pagesa e principalit janë në vonesë, por Banka beson se kalkulimi i humbjes së vlerës nuk është e përshtatshme në bazë të nivelit të sigurisë / kolateralit në dispozicion dhe/ose fazës së arkëtimit të shumës së huasë.

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

**4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(a) Risku kreditor (vazhdim)**

*Lejimet për rënien në vlerë*

Banka ka themeluar fond për humbjet nga rënia në vlerë që përfaqëson vlerësimin e humbjeve të ndodhura të portfolios.

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
<b>Kreditë dhe paradhëniet për klientët, neto</b>		
As në vonesë e as të provizionuara	78,468,883	53,058,338
Në vonesë dhe të provizionuara	588,071	-
Në vonesë por jo të provizionuara	225,365	1,432,976
<b>Totali</b>	<b>79,282,319</b>	<b>54,491,314</b>

Analiza e ekspozimit të riskut kreditor sipas ditëve në vonesë është si më poshtë:

<b>Kategoria (vjetërsia)</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Standarde (0 ditë në vonesë)	78,749,333	53,304,171
Standarde (0-30 ditë në vonesë)	1,519	1,502,824
Vrojtuese (31-60 ditë në vonesë)	254,584	83,507
Nën Standard (61-90 ditë në vonesë)	770,265	-
Të dyshimta (91-180 ditë në vonesë)	45,312	-
Humbje (mbi 180 ditë në vonesë)	2,304,066	-
Interesi akruar	240,313	-
Minus: Tarifa e shtyrë e disbursimit	(133,510)	(80,895)
<b>Totali i kredive me kosto të amortizuar, bruto</b>	<b>82,231,882</b>	<b>54,809,607</b>
Minus: Provizionin për humbjet nga kreditë	(2,949,563)	(318,293)
<b>Totali i kredive dhe paradhënieve për klientët, neto</b>	<b>79,282,319</b>	<b>54,491,314</b>

Më poshtë është një analizë e kolateralit të marrë si mbulim në lidhje me kredië dhe paradhëniet për klientët:

<b>Kreditë dhe paradhëniet për klientët</b>	<b>Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor</b>		<b>Total kolateral</b>		<b>Ekspozimi Neto</b>
	<b>Patundshmëri</b>			<b>Kolateral tepërt</b>	
<b>31 dhjetor 2017</b>	79,282,319	208,791,001	74,948,677	123,508,682	6,000,000
<b>31 Dhjetor 2016</b>	54,491,314	197,609,163	54,491,314	143,117,849	-

Banka nuk është e lejuar që të shesë po të lë peng kolateralin sipas kontratës së kredisë në mungesë të mospagesës nga pronari i kolateralit.

Ekspozimi neto përbëhet nga një kredi për një klient të grupit të miratuar nga qendra, për të cilat kolaterali nuk mbahet në nivel lokal, por në nivelin e Kompanisë mëmë.

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

**4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(b) Koncentrimi**

Is Banka ka një strategji kreditimi që përcakton llojet e investimeve (koncentrimet) duke u bazuar kryesisht në segmentet ekonomike siç janë industria, tregtia, ndërtimi, etj. Pasi që Republika e Kosovës është e vogël, koncentrimi gjeografik brenda Kosovës nuk është i rëndësishëm; kjo strategji rishikohet dhe përditësohet në baza vjetore nga Bordi Menaxherial apo Banka.

Tabela e mëposhtme zbërthen ekspozimin kryesorë të bankës në vlerat e tyre neto, të kategorizuar në bazë të sektorit të industrisë së palëve.

Me 31 dhjetor 2017 dhe 2016, analiza e kredive për konsumatorë dhe bankave në bazë të sektorit të industrisë ishte si mëposhtë:

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Tregtia me shumicë dhe pakicë	49,926,751	41,188,442
Shërbime të ofrimit të energjisë elektrike, gazit dhe klimës	12,570,000	-
Ndërtimtari	9,090,686	4,847,657
Prodhim	5,340,869	4,361,166
Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	1,372,617	1,300,858
Furnizimi me ujë, kanalizimi dhe menaxhimi i mbeturinave dhe shërbimet	1,075,947	1,391,176
Individuale	1,063,095	550,430
Miniera dhe gurore	750,938	344,894
Shërbime të tjera	528,263	-
Transporti dhe magazinimi	248,117	234,681
Shërbimet administrative dhe mbështetëse	78,880	115,533
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	39,539	312,097
Informacioni dhe komunikimi	39,377	35,909
Interesi akrual	240,313	207,659
Të ardhurat e shtyra në tarifën e disbursimit	(133,510)	(80,895)
<b>Totali i Kredive me kosto të amortizuar, bruto</b>	<b>82,231,882</b>	<b>54,809,607</b>
Minus: Provizionin për humbjet nga kreditë	(2,949,563)	(318,293)
<b>Huatë dhe paradhënit për klientët, neto</b>	<b>79,282,319</b>	<b>54,491,314</b>

Tabela në vijim përfaqëson 5 ekspozimet më të larta neto të bankës:

<b>Emri i klientit</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>Emri i klientit</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Albi Commerce sh.p.k.	14,516,803	Albi Commerce sh.p.k.	13,655,476
Kastrati sh.p.k.	8,062,995	Kastrati sh.p.k.	7,072,389
Elkos sh.p.k.	7,609,146	Elkos sh.p.k.	9,521,650
Hidroenergji sh.p.k.	6,494,070	Alfa shpk	3,620,342
Air-energy sh.p.k.	5,932,484	Rroni Fer shpk	1,800,945

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

**4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(c) Risku i likuiditetit**

Risku i likuiditetit është risku që Banka do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve të lidhura me detyrimet financiare që lidhen me dhënien e mjeteve monetare ose ndonjë pasurie tjetër financiare. Risku i likuiditetit mund të ndodhë si rezultat i financimit të pasurive afatgjata me burime afatshkurtëra. Me kujdes mbahet konsistenca ndërmjet maturiteteve të pasurive dhe detyrimeve; strategjitë përdoren për të marrë fonde afatgjata.

Bazuar në parashikimet e rrjedhës së parasë, çmimet janë të diferencuara për maturime të ndryshme dhe si rrjedhojë janë marrë masat për të përmbushur kërkesat e likuiditetit; për më tepër vlerësohet likuiditeti që mund të jetë i nevojshëm për rrethana të jashtëzakonshme dhe përcaktohen burimet alternative të likuiditetit për shfrytëzime të mundshme.

Qëllimi i Menaxhimit të Riskut të Likuiditetit është të sigurojë sa më shumë që është e mundshme, që vazhdimisht do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të plotësuar detyrimet me kohë, në kushte normale dhe të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikojë dëmtimin e reputacionit të Bankës. Menaxhimi i riskut të likuiditetit trajtohet në bashkëpunim dhe nën mbikëqyrjen e Departamentit të Grupit të Thesarit në Zyrën Qëndrore. Më 31 dhjetor 2017, pasuritë, detyrimet dhe kapitali aksionar i Bankës kanë maturitet të mbetur si më poshtë:

<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1-3 muaj</b>	<b>3-12 muaj</b>	<b>1-5 vite</b>	<b>Mbi 5 vite</b>	<b>E pa specifikuar</b>	<b>Totali</b>
<b>Pasuritë</b>							
Paraja dhe balanca me Bankën Qendrore	11,442,144	-	-	-	-	7,000,000	18,442,144
Investime në letra me vlerë	-	-	499,963	120,236	-	-	620,199
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	6,456,247	7,614,074	30,344,848	28,981,513	5,885,637	-	79,282,319
<b>Totali i pasurive</b>	<b>17,898,391</b>	<b>7,614,074</b>	<b>30,844,811</b>	<b>29,101,749</b>	<b>5,885,637</b>	<b>7,000,000</b>	<b>98,344,662</b>
<b>Detyrimet</b>							
Depozitat nga klientët	8,258,072	2,311,185	23,350,391	8,889,299	-	-	42,808,947
Huatë afatshkurtëra	5,174,265	-	351,337	-	-	-	5,525,602
Detyrime ndaj kompanisë mëmë	4,250,761	14,780,151	21,683,745	1,472,286	-	-	42,186,943
Detyrime të tjera	21,168	54,725	-	-	-	-	75,893
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitali aksionar</b>	<b>17,704,266</b>	<b>17,146,062</b>	<b>45,385,473</b>	<b>10,361,585</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>90,597,385</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>194,125</b>	<b>(9,531,987)</b>	<b>(14,540,662)</b>	<b>18,740,164</b>	<b>5,885,637</b>	<b>7,000,000</b>	<b>7,747,277</b>
<b>Pozicioni kumulativ neto</b>	<b>194,125</b>	<b>(9,337,862)</b>	<b>(23,878,524)</b>	<b>(5,138,361)</b>	<b>747,277</b>	<b>7,747,277</b>	<b>-</b>

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

**4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(c) Risku i likuiditetit (vazhdim)**

<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>Deri në 1 muaj</b>	<b>1-3 muaj</b>	<b>3-12 muaj</b>	<b>1-5 vite</b>	<b>Mbi 5 vite</b>	<b>E pa specifikuar</b>	<b>Totali</b>
<b>Pasuritë</b>							
Paraja dhe balanca me Bankën Qendrore	9,564,150	-	-	-	-	4,000,000	13,564,150
Investime në letra me vlerë	249,993	3,525,620	752,542	117,720	-	-	4,645,875
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	1,724,536	3,056,811	18,239,833	27,280,495	4,189,639	-	54,491,314
<b>Totali i pasurive</b>	<b>11,538,679</b>	<b>6,582,431</b>	<b>18,992,375</b>	<b>27,398,215</b>	<b>4,189,639</b>	<b>4,000,000</b>	<b>72,701,339</b>
<b>Detyrimet</b>							
Depozitat nga klientët	8,068,022	2,538,105	17,121,767	3,186,452	-	-	30,914,346
Huatë afatshkurtëra	7,403,828	-	501,467	-	-	-	7,905,295
Detyrime ndaj kompanisë mëmë	5,701,290	4,914,121	12,929,424	-	1,601,777	-	25,146,612
Detyrime të tjera	65,802	-	-	-	-	-	65,802
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar</b>	<b>21,238,942</b>	<b>7,452,226</b>	<b>30,552,658</b>	<b>3,186,452</b>	<b>1,601,777</b>	<b>-</b>	<b>64,032,055</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(9,700,263)</b>	<b>(869,795)</b>	<b>(11,560,283)</b>	<b>24,211,763</b>	<b>2,587,862</b>	<b>4,000,000</b>	<b>8,669,284</b>
<b>Pozicioni kumulativ neto</b>	<b>(9,700,263)</b>	<b>(10,570,058)</b>	<b>(22,130,341)</b>	<b>2,081,422</b>	<b>4,669,284</b>	<b>8,669,284</b>	<b>-</b>



**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

**4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(d) Risku i tregut**

**i. Risku i valutave të huaja**

Risku i valutave të huaja është risku që vlera e instrumenteve financiare ndryshon për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit të huaj. Banka e menaxhon këtë risk duke vendosur dhe monitoruar limite mbi pozicionet e hapura dhe gjithashtu duke siguruar që këto pozicione të mbeten në përputhje me udhëzimet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe limiteve të brendshme operative të bankës. Banka ka procedura për kontrollin e pavarur të pozicioneve të hapura valutore. Zyra Qendrore menaxhon pozicionet në valutë të huaja dhe mirëmban pozicionet e monedhës së Bankës në mënyrë të vazhdueshme. Valutat e huaja me të cilat punon Banka janë kryesisht Dollari i SHBA-së (USD), Lira e Turqisë (TRY), Franga e Zvicrës (CHF) dhe Funta e Britanisë së Madhe (GBP). Megjithatë, këto transaksione janë të kufizuara dhe pasuritë dhe detyrimet e shprehura në valutë të huaj janë të parëndësishme në datën e pozicionit financiar. Si rezultat, banka nuk është e ndjeshme ndaj ndryshimeve në normat e monedhës së huaj.

Normat e këmbimit të përdorura për konvertimn e valutave të huaja me 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si vijon:

<b>Në krahasim me EUR</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
1 USD	0.8338	0.9487
1 TRY	0.2200	0.2697
1 GBP	1.1271	1.1680
1 CHF	0.8546	0.9312

Tabela e mëposhtme paraqet shumën ekuivalente të pasurive, detyrimeve dhe kapitalit aksionar sipas monedhave më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 të ekuivalentuar në Euro:

<b>2017</b>	<b>EUR</b>	<b>TRY</b>	<b>USD</b>	<b>GBP</b>	<b>CHF</b>	<b>Totali</b>
<b>Pasuritë</b>						
Paraja dhe balanca me BQK	18,348,828	93,316	-	-	-	18,442,144
Investime në letra me vlerë	620,199	-	-	-	-	620,199
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	79,182,929	-	99,390	-	-	79,282,319
<b>Totali i pasurive</b>	<b>98,151,956</b>	<b>93,316</b>	<b>99,390</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>98,344,662</b>
<b>Detyrimet</b>						
Depozitat nga klientët	41,861,403	-	684,901	172,100	90,543	42,808,947
Huatë afatshkurtëra	5,525,602	-	-	-	-	5,525,602
Detyrime ndaj kompanisë mëmë	41,973,053	-	134,258	79,632	-	42,186,943
Detyrime të tjera	75,893	-	-	-	-	75,893
<b>Totali</b>	<b>89,435,951</b>	<b>-</b>	<b>819,159</b>	<b>251,732</b>	<b>90,543</b>	<b>90,597,385</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>8,716,005</b>	<b>93,316</b>	<b>(719,769)</b>	<b>(251,732)</b>	<b>(90,543)</b>	<b>7,747,277</b>

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

**4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(d) Risku i tregut (vazhdim)**

*i. Risku i valutave të huaja (vazhdim)*

<b>2016</b>	<b>EUR</b>	<b>TRY</b>	<b>USD</b>	<b>GBP</b>	<b>CHF</b>	<b>Totali</b>
<b>Pasuritë</b>						
Paraja dhe balanca me BQK	13,557,937	6,213	-	-	-	13,564,150
Investime në letra me vlerë	4,645,875	-	-	-	-	4,645,875
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	54,389,475	-	101,839	-	-	54,491,314
<b>Totali i pasurive</b>	<b>72,593,287</b>	<b>6,213</b>	<b>101,839</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>72,701,339</b>
<b>Detyrimet</b>						
Depozitat nga klientët	30,098,806	-	582,908	207,554	25,078	30,914,346
Huatë afatshkurtëra	7,905,295	-	-	-	-	7,905,295
Detyrime ndaj kompanisë mëmë	24,763,328	-	300,754	82,530	-	25,146,612
Detyrime të tjera	65,802	-	-	-	-	65,802
<b>Totali</b>	<b>62,833,231</b>	<b>-</b>	<b>883,662</b>	<b>290,084</b>	<b>25,078</b>	<b>64,032,055</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>9,760,056</b>	<b>6,213</b>	<b>(781,823)</b>	<b>(290,084)</b>	<b>(25,078)</b>	<b>8,669,284</b>

**Türkiye İş Bankası A.Ş. – DEGA NË KOSOVË**  
**PASQYRAT FINANCIARE**

*Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017*  
*(Shumat në Euro, përveç nëse është specifikuar ndryshe)*

**4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**(d) Risku i tregut (vazhdim)**

**ii. Risku i normës së interesit**

